

**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

" ICC " Sh.p.k

Sot më datë 22 / 07 / 2024 , u paraqitë pala e mëposhtme:

- **Z. Alktion Cali**, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, Shqiperi, më 13.09.1986 dhe banues në Rr.Him Kolli,30, Tirane, mbajtës i kartës së identitetit me nr 033459667 dhe me Numer Personal I60913041E madhor dhe me zotësi të plote per te vepruar,

ka vendorus të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

Neni 1 — Forma

- 1.1 Shoqëria " ICC " Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të ketij Statuti.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çeshtjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 — Emërtimi

2.1 Emërtimi i Shoqërisë është " ICC " Sh.p.k

Neni 3 — Objekti i shoqërisë

3.1 Objekti i shoqërisë është:

- Realizimi, drejtimi, tregimi dhe shperndarja, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë shtetit, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë-për llogari të vetën dhe / ose të të tretëve- të prodhimeve dhe programeve software, faqeve web, dhe siti inter-aktive virtuale në internet, që përbëhen nga tekse, pamje, tinguj dhe informacione, edhe on-line në kohë reale;
- Kërkimet, zhvillimi, prodhimi dhe shpërndarja e produkteve dhe shërbimeve editoriale dhe informatike, telematike dhe multimedias, si dhe mbledhjen e informacionit dhe të dhënavë për krijimin dhe sigurimin e shërbimeve të botimeve telematike dhe elektronike
- Konsulencë, tregimi i cdo lloj pasurie, sherbimi, mbeshtetje, konsulencë ne lidhje me aktivitetet e mesiperme duke përdorur instrumente prej letre, informatike, telematike dhe multimediale në internet (e-commerce)
- Organizimi dhe drejtimi për llogari të të tretëve ,një bashkësi elementesh të telekomunikimit, informatik dhe njerezor, përbërës për të drejtuar në mënyrë eficiente dhe efikase telefonata në dalje (outbound) dhe në ardhje (inbound), ku realizohen ose merren telefonata në një numër të caktuar për qëllimin për të realizuar aktivitete shitje, marrjen e porosive, asistencës të klientelës (CUSTOMER SERVICE), shërbime mirësjellje dhe opinion, Telemarketingu, mbështetjes teknike (HELP DESK), Call Dispatching, sekretari kongresesh dhe seminaresh, numra të gjelbër, drejtimin e kontakteve,



shërbime vokale dhe me karakter informativ dhe profesional dhe aktivitete të tjera që janë të lidhura me botën e tregtisë. Kërkimet e tregut, sondazhet e opinionit, kërkesat për mediat në tregues të ndryshëm sasior; eksperimentimin shkencor – statistik të përfunduar për kërkimet dhe individualizimet e metodologjive të reja.

- Kërkimet e tregut, sondazhet e opinionit, kërkesat për mediat në tregues të ndryshëm sasior, eksperimentin shkencor, statistik të përfunduar për kërkimet dhe individualizimet e metodologjive të reja
- Zhvillimin dhe realizimi i kurseve të formacioneve dhe seminareve, si dhe organiizmi i kongreseve dhe konferencave për llogari të tyre ose të të tretëve;
- Sigurimin e shërbimeve telematike on-line rreth telefonise celulare për shoqëritë dhe privatët;
- Asistencë informatike, telematike, teknologjia para dhe pas shitjes si për llogari të vetën ashtuu dhe për llogari të të tretë, optimizimin e strategjive të komunikimit shoqëror, planifikimin e organizuar afatmesëm dhe afatshkurtër
- Administrumin dhe organizimi i kërkimit dhe projektimit, zhvillimi dhe realizimi I procedurave të kontrollit të tregut dhe sistemeve te nxitjes se personelit te shitjeve, si me ane te mbeshtetjes informatike dhe telematik
- Konsulence, tregtimi i cdo lloj pasurie, sherbimi, mbeshtetje, konsulence ne lidhje me aktivitetet e mesiperme duke përdorur indtrumente prej letre, informatike, telematike dhe multimediale në internet (e-commerce)

Neni 4 — Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Tirane Rruga “Besim Imam”, Ndertesa nr.1; Kati 2, Hyrja 12; Njesia nr.10, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjeter bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërise si dhe jashtë saj.

Neni 5 — Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblese së Ortakëve.

KAPITULLI II


KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 — Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) LEK.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërise përbhet nga 1 (nje) kuot, e nënshkruar në të holla, me vlerë nominale 100 (njëqind) LEK

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
 - **Alktion Cali** do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 100 (pesedhjete) LEK, nëpërmjet depositimit në llogarinë bankare të shoqërisë në themelim e sipër.


7.2 Sipas kontributeve të mësipërm:

- **Alktion Cali** eshtë zotëruar i 1(një) kuote me vlerë 100 (pesedhjete) LEK, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 8 — Rritja a kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi ne çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblese së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejten të nenshkuajnë rritjen në raport me pjeset e kapitalit të zoteraura. Në rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nenshkuhen nga ortaket e tjera proporcionalisht me pjeset e kapitalit të zoteraura prej tyre.

Neni 9 — Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogelohet nën kufijt e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakeve në të njejtën masë me pjeset e kapitalit të zoteraura prej tyre.

Neni 10 — Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin me të gjere të fjalës, duke perfshirë ketu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjera të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me pare t'i ofrohen në parablerje ortakeve të tjera.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njostojë ortakët e tjera me letër rekomande me kthim perqigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar per shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në disposicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zoterojnë, përvèç rastit kur ka një marreveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrou pjesërisht të drejten e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie "mortis causa" ortakët e tjera kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortaket e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblese së Ortakëve. Në marrjen e vendimit të Asamblesë së Ortakëve duhet të jenë të pranishern ortakët që përfaqësojnë të pakten 51% (pesëdhjetënjë përqind) të kapitalit themeltar, dhe vendimi duhet të merret me votë pro të paktën 3/4 (tre të katërtat) të ortakëve të pranishëm. Në rast se nuk arrihet një vendim pro transferimit të kuotave, atëherë do të procedohet me likuidimin e kuotës së trashëgimisë. Përcaktimi i vlerës së kuotës të vënë në likuidim do to kryhet me marrëveshje midis palëve. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, palët, me marrëveshje midis tyre do të emërojnë një vlerësues i cili do të përaktekoje vlerën e kuotës që do të likuidohet. Në rast se nuk arrihet një marreveshje as në këtë pikë, vlerësuesi do të emërohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë me kërkësën e palës së interesuar.

Neni 11 — Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqerisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjese për marrjen e vendimeve për çeshtjet vijuese: ndryshimet e satutit, emërimi i shkarkimi i administratorëvë, eksperteve kontabel e likuidatoreve, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërise, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.

Neni 12 — E drejta e pjesernarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa ështe numri i kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të perfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojoë prokurë per votim per një pjesë të kapitalit që zoteron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 — Thirrja e Asamblesë së Ortakevë, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që perfaqësojnë të pakten 5% (pesë perqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpermjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve— në adresën e ortakëve ose nëpërmjet emailit në adresën elektronike të secilit ortak dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpëra mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përbaje informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çeshtjet që do të trajtohen dhe për të cilat do to merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, veç në Itali ose në Shqiperi.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar ne pikën 13.7 të ketij Statuti, Asambleja e Ortakeve do të thirret brenda 30 (tridhjete) ditesh me të njejtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithe pjesëmarresit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të nderhyjne në momentin e trajtimit të çeshtjeve në rend të ditës; pasi të janë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojne në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblese së Ortakëve, për të cilat kërcohët një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojne me shume se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese së Ortakëve që kërkojnë një shumice të cilesuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojne të pakten 51 % (pesedhjete e një perqind) të kapitalit themeltar.

13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e satutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të 3/4 (tre të katërtave) e ortakëve të pranishem që zoterojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një perqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zoterojnë me shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

13.9 Çdo Asamble drejtobet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 — Administrimi

14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

Administrator i shoqërisë i cili do të emërohet në momentin e themelimit të shoqërisë Z.Alketion Cali shtetas shqiptar, i datëlindjes 13.09.1986, me Numer Personal I60913041E

14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund te ushtroj të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet ne nenin 95 te Ligjit n. 9901 te datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

14.3 Administratori mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15 — Audituesi Ligjor

15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.

15.2 Audituesi ligjor mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legislacioni ne fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti finansiar dhe bilanci vjetor

16.1 Viti finansiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit.

16.2 Viti i parë finansiar fillon në daten e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombetare Regjistrimit dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtë vit.

16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit n. 9901 te datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"

16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin finansiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit finansiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojne nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcione pjeset e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHGQERISE

Neni 18 — Prishja

- 18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga Ligji, ose me ane të një vendimi të asamblese së Ortakëve, me shumicen e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotesise per të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakeve.

Neni 19 — Likuidimi

- 19.1 Në rast shpërbërjeje, shoqëria do të vendoset në likuidim
- 19.2 Për ta administruar këtë procedure, Asambleja emëron një ose me shumë likuidatore, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per të perfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendose mbi bilancin finanziar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit to likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditoreve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndaje të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcione pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në per gjithë midis ortakëve (perveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtperdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirana.

Neni 21 — Gjuha

- 21.1 Ky Statut është hartuar ne 2 (dy) kopje në gjuhen shqipe .
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe / ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në italisht do to jetë i vetmi dhe do to jetë ligjërisht detyrues.

ORTAK I VETËM

Alkefirion Cali